



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development
**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agjencia za Razvoj Poloprivrede/ Agriculture
Development Agency**

ZYRA PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN/KANCELARIJA ZA JAVNO KOMUNICIRANJE/
/OFFICE OF PUBLIC COMMUNICATION/

THIRRJE PËR APLIKIM
PËR EKONOMITË BUJQËSORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PËR PËRFITIM NË KUADËR TË IMPLEMENTIMIT TË “PLANIT PËR BUJQËSI
DHE ZHVILLIM RURAL 2014-2020”, MBESHTETJE PËR INVESTIME MASA
“SKEMA NACIONALE E GRANTEVE PËR UJITJEN E TOKAVE BUJQËSORE”

1. Qëllimi i thirrjes për aplikim

Qëllimi i thirrjes për aplikim është dhënia e mbështetjes financiare/granteve për investime në ferma në kuadër të Masës “ Skema nacionale e granteve për ujitjen e tokave bujqësore”.

2. Përfituesit e mundshëm

- Kompanitë e ujitjes;
- Komuna;
- Shoqatat e përdorueseve të ujit.

3. Shtrirja gjeografike

Tërë territori i Republikës së Kosovës

4. Investimet e pranueshme

- Rehabilitimi dhe zgjerimi i kanaleve dhe gypave të ujitjes;
- Ndërtimi i rezervuarëve të ujit;
- Penda e ujitjes;
- Ndërtimi i drenazhës/kullimit;
- Pompat e ujitjes dhe pajisjet e tjera përcjellëse (pajisje për matjen e ujit, për rrymë, etj);
- Rehabilitimi i pajisjeve (valvulat, lidhëset, gypat, përfshirë edhe punën);
- Punët përcjellëse me ndikim në mjedis, drenazhim (tarracat, nivelimi i tokës, varësisht nga lloji i projektit);

Shpenzimet që janë të lidhura me përgatitjet projektit janë të pranueshme për përkrahje deri në 10% të shpenzimeve të pranueshme;

- Skicat/dizajnimet e hollësishme të projektit inxhinierik;
- Vlerësimi i ndikimit mjedisor;
- Përgatitja e dokumenteve të aplikimit.

Intensiteti i mbështetjes publike është 80% e shpenzimeve të pranueshme. Kosto minimale e investimit të pranueshëm është 15,000 euro, ndërsa ajo maksimale 150.000 euro.

5. Dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit me projekt propozimin, sipas formës standarde të MBPZHR-së;
- Kopja e një llogarie bankare të vlefshme;
- Kopja e letërnjoftimit të menaxherit dhe të personit të autorizuar (përfaqësues të biznesit);
- Deklarata e përfituesit për të bërë mirëmbajtjen e infrastruktures së mbështetur për të paktën 3 vjet dhe të jetë nën kontrollin e Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë. Nëse kjo nuk ndodh atëherë përfituesi duhet të kthejë mbështetjen financiare të pranuar mbrapa.

Pas përzgjedhjes së projektit kërkohet:

- Kopja mbi vlerësimin e ndikimit mjedisor nga MMPH-ja, të paraqitet para pagesës së parë;

- Leja për ndërtim, të paraqitet para pageses së parë;
- Kërkesa për pagesë duhet të përmbajë edhe dëshminë se është zhvilluar procedura e prokurimit.

Të gjithë përfituesit e projekteve duhet të respektojnë rregullat dhe procedurat e prokurimit publik që janë të bashkangjitura si shtojcë e kontratës që fermeri e nënshkruan me Agjencionin e Zhvillimit të Bujqësisë.

Koha dhe mënyra e pranimit të aplikacioneve

- Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 45 ditë nga data e publikimit;
- Data e fillimit të dorëzimit të formularit për aplikim është dita pasi të jetë publikuar thirrja për aplikim;
- Nga data e publikimit, procedimi i aplikacioneve do të bëhet sipas parimit të kritereve të përzgjedhjes të përcaktuara paraprakisht nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Formulari për aplikim dhe dokumentet e bashkangjitura duhet të dorëzohen në Zyrën Regjionale të Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan nga ora 8,30-16,00 çdo ditë pune.

Per informata më të hollësishme vizitoni web faqen www.mbpzhr-ks.net ,web faqen www.azhb.rks-gov.net si dhe udhëzuesin për aplikues.

Kontaktet dhe pikat (vendet) informuese lidhur me aplikimin

MBPZHR/AZHB			
Adresa: Rr: Nazim Gafurri nr.24 (afër gjimnazit "Sami Frashëri)			
Nga e hëna deri të premten nga ora 10:00-12:00			e-maili
1	Nehat Veliu	038 211 967	nehat.veliu@rks-gov.net
2	Habibe Dauti		habibe.dauti@rks-gov.net
3	Berat Nika		berat.nika@rks-gov.net
4	Veton Prekazi		veton.prekazi@rks-gov.net

Çdo ditë pune nga ora 08:30-16:00

Nr.	Regjioni	Adresat	Telefoni	e-maili
1	Prishtinë	ZONA INDRUSTIALE-Fushë Kosovë, Përballë Maxi-Marketit,	038 601 169	
2	Mitrovicë	Mbretëresha Teutë pa nr.	028 522 501	
3	Pejë	Instituti Bujqësor, Fidanishtja Pejë	039 431-276	
4	Gjakovë	Marin Barleti nr.2,kati III.	0390 320-992	
5	Prizreni	Avni Rrustemi 159	029 244-793	
6	Ferizaj	Dëshmoret e kombit pa nr.	0290 324 661	
7	Gjilan	Rr: Bulevardi i Pavarësisë (Rr. e Ferizajt) (Soliteri kati I)	0280 326 106	